

VENDIM

Nr. 816, datë 30.12.2025

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 837, DATË 26.12.2024, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE NË BASHKITË Durrës, Kamzë, Mirditë, Shijak, Krujë dhe Vorë”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 837, datë 26.12.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të banesave individuale në bashkitë Durrës, Kamzë, Mirditë, Shijak, Krujë dhe Vorë”, bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2025, nga bashkitë Durrës, Shijak, Krujë dhe Vorë, në masën 501 942 235 (pesëqind e një milionë e nëntëqind e dyzet e dy mijë e dyqind e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para, në bazë të aktekspertizave të thelluara, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Durrës i transferohet fondi, në masën 136 643 876 (njëqind e tridhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e dyzet e tre mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH;

b) Bashkisë Shijak i transferohet fondi, në masën 46 682 144 (dyzet e gjashtë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy mijë e njëqind e dyzet e katër) lekë pa TVSH;

c) Bashkisë Krujë i transferohet fondi, në masën 177 818 041 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë milionë e tetëqind e tetëmbëdhjetë mijë e dyzet e një) lekë pa TVSH;

ç) Bashkisë Vorë i transferohet fondi, në masën 140 798 174 (njëqind e dyzet milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.”.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1. Efekti financiar, për vitin 2025, përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2025, dhe i transferohet bashkive Durrës, Shijak, Krujë dhe Vorë në formën e transfertës së pakushtëzuar.”.

II. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe bashkitë Durrës, Shijak, Krujë dhe Vorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama